



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

## PROVIMI I MATURËS

JANAR 2019

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

### U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.  
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.  
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërën prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tuaja.

**Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:**

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja. Me fat!

**Me fat!**



\* A 9 1 9 4 7 \*



# FAQE E ZBRAZËT

## Në bazë të Tekstit 1 përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

### Teksti 1

*Selaniku, posedon madhësinë, gjallërinë dhe ambiciet e metropoleve moderne botërore, kurse mungesën e përmendoreve nga e kaluar e Greqisë e kompenson me kisha të shumta bizantine, me muze të shkëlqyeshëm, me restorante dhe me një jetë të natës shumë të bujshme*

Qyteti i dytë i Greqisë dhe qendra administrative e dy rajoneve veriore, Selaniku, ndodhet në majë të gjirit të Selanikut pranë të cilit shtrihet me një gjatësi prej 20 km. Në perëndim të qytetit është fusha e Selanikut, ultësira bregdetare afër grykës së Vardarit në gji. Nga anët tjera qyteti është i rrethuar me malet e bjeshkës Horthiatis. Pamja moderne e qytetit i detyrohet zjarrit katastrofik të vitit 1917 i cili i rrafshoi shumicën e shtëpive të vjetra përgjatë labirintit të shtigjeve otomane, duke përfshi edhe të gjithë Lagjen e Hebrenjve, duke lënë 70.000 banorë, gati gjysmën e popullatës së atëhershme, pa pullaz mbi kokë. Qyteti është rindërtuar gjatë tetë vjetëve në vazhdim sipas planit i cili është përgatitur nën mbikëqyrjen e arkitektit dhe arkeologut francez Ernesto Erbar, me avenytë e gjata dhe qendrore, paralele me bregun e detit, si dhe me rrugët tërthore të ngjeshura me drurë të cilët të mbrojnë nga dielli. Selaniku sot është një qytet universitar, port i përparuar, qendër industriale dhe kulturore.

Selaniku është një qytet me histori të komplikuar të cilin mjaft e konsideronin të vetin: bizantinë, venedikasit, turqit, hebrenjtë, grekët, jermenët... Gjurmët e tyre gjenden gjithandej, disa prej tyre ndërkohë janë bërë simbole turistike të qytetit, sikurse Kulla e Bardhë... Qyteti është themeluar diku rreth vitit 315 para epokës së re: e ka themeluar Kasandri, mbreti maqedonas, dhe e emërtoi sipas bashkëshortes së tij të dashur Thesaloniki, motrës prej babës të Aleksandrit të Madh. ... Kur romakët pushtuan qytetin në vitin 168 para epokë së re, Selaniku u bë kryeqyteti i një province romake. Gjatë kohë së udhëtimit në Maqedoni papa i shenjtë Pali ka predikuar në sinagogën lokale, e cila ka qenë kryesorja për hebrenjtë e atij rajoni, dhe ka vendosur themelet e krishterimit dhe kishës. ... Selaniku ka qenë një nga qendrat më të rëndësishme në Bizant, posaçërisht gjatë sundimit të Komninit, ndërsa në të kanë lindur Qirili dhe Metodi.

(...)

Muzeu arkeologjik i qytetit konsiderohet si një nga më të mirët në Evropë. Posedon një koleksion të madh, duke përfshirë gjëra me vlerë të pabesueshme në formën e varrit të atit të Aleksandrit të Madh, Filipit të Maqedonisë, i cili është zbuluar në Vergjini në vitin 1977. Në sheshin Dikasterion është një lokalitet arkeologjik i tregut të lashtë grek i cili është rregulluar më vonë në një forum romak me dy nivele. Forumi ishte zemra e qytetit të lashtë, kurse e kanë zbuluar punëtorët në vitet e gjashtëdhjeta. Pjesa më e ruajtur e forumit është teatri i madh, i cili ende përdoret për koncerte të verës. Kulla e Bardhë është pjesa më e njohur e qytetit,

kurse në formë origjinale është ndërtuar si pjesë e mureve të qytetit. Ajo ndodhet në shëtitore pranë detit, në jug nga muzeu arkeologjik. Në qytetin e sipërm, përveç shtëpive prej drurit nga periudha otomane dhe mbetjeve të mureve të qytetit nga koha bizantine, gjendet Sheshi i Aristotelit, sheshi më i rëndësishëm i qytetit. Në vetë qytetin e Selanikut ekzistojnë disa kisha të cilat numërohen ndër më të bukurat në botën ortodokse: Shën Sofia, Dymbëdhjetë Apostujt, Kisha e profetit Elijah, Shën Pantelejmoni...

(...) Jeta natës në qytet është shumë e pasur, e zhurmshme dhe e llojlojshme dhe e njohur shumë larg. Nga anijet –diskotekat e deri te klubet alternative, kafenetë e shkëlqyeshme penthaus... Zona më moderne e jetës së natës është Ladadika, afër portit.

*(përgatitur sipas tekstit të S. O., Styl, 8 qershor 2009)*

### **1. Teksti është një fragment nga:**

1. lajmi
2. komenti
3. reportazhi

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

*1 pikë*

### **2. Cila ngjarje ka ndikuar në mënyrë të vendosur në ndryshimin e pamjes së Selanikut në shekullin 20?**

1. Zbulimi i forumit romak në dy nivele me teatrin e madh në vitet e 60-ta.
2. Zjarri katastrofik në vitin 1917 i cili i rrafshoi shtëpitë e vjetra në lagjen hebreje.
3. Transferimi i varrit të Filipit të Maqedonisë në Selanik, të zbuluar në vitin 1977 në Vergjini.

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

*1 pikë*

### **3. Kush është themelues i qytetit?**

1. Ernest Erbari
2. Kasandri
3. Aleksandri i Madh
4. Aristoteli

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.*

*1 pikë*

**4.** Përse përmendet në tekst Thesalonika, motra prej babait e Aleksandrit të Madh?

---

1 pikë

**5.** A) Kulla e Bardhë në Selanik është pjesë e trashëgimisë së:

1. periudhës antike
2. periudhës romake
3. periudhës otomane
4. periudhës bizantine

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

**B) Argumentoje përgjigjen.**

---

---

1 pikë

**Duke shfrytëzuar Tekstin 2 zhvillo detyrat 6 dhe 7.**

### **Teksti 2**

Do t'ju habisë bukuria e Tivarit. Do të pushtoheni nga qyteti i vendosur rrëzë malit të Rumisë, në mes të dy ujërave të mëdha, Detit Adriatik dhe Liqenit të Shkodrës. Deti, liqeni dhe rajonet malore sjellin atraksionet unike triptikë dhe i kënaqin shijet më turistike.

Nëse jeni i dashuruar në udhët ujore, Tivari do t'ju pres me portin bashkëkohor dhe me një marinë të pajisur në mënyrë të përkryer.

Në përfitimet e diellit dhe detit të ngrohtë, mund të kënaqeni në plazhet e bukura dhe të gjata me rërë ose me dunat e egra e të fshehura të rërës.

Parku Kombëtar i Liqenit të Shkodrës me botën unike të bimëve dhe kafshëve dhe një arkipelag magjeps ofron një përvojë të paharruar turistike.

Monumentet e shumta kulturore dhe Qyteti i Vjetër i Tivarit dëshmojnë për përhapjen e këtushme të kulturës ortodokse, katolike dhe islame.

Bukuria e kontrasteve natyrore dhe harmonia e bashkëjetesës do të ngroh zemrën tuaj, do t'ua mbush shpirtin..

*Mirë se vini në Malin e Zi, mirë se vini në Tivar!  
Organizata Turistike e Tivarit, KK Tivar*

**6.** A) Kujt i kushtohet teksti?

---

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

---

---

1 pikë

**7.** Me cilin stil funksional është shkruar teksti?

---

1 pikë

Duke shfrytëzuar Tekstin 1 dhe Tekstin 2 zhvillo detyrat 8, 9 dhe 10.

**8.** A) Cilit tekst i përgjigjet titulli *Qyteti modern me traditë të gjatë?*

---

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

---

---

1 pikë

9. Kujt i referohen të dhëna në tabelë Selanikut apo Tivarit? Nëse të dhënat u referohen të dy qyteteve, rretho PO, ndërsa nëse e dhëna nuk ka të bëjë me të dy qytetet, rretho JO.

| E DHËNA KA TË BËJ EDHE ME SELANIKUN DHE ME TIVARIN                | PO | JO |
|---|----|----|
| Qytete turistike dhe porte të mëdha                               | PO | JO |
| Sheshet të mëdha romake të shndërruara në skena                   | PO | JO |
| Monumente të shumta të kulturës romake, otomane dhe ortodokse     | PO | JO |
| Prapa qytetit ndodhen kreshtat e larta malore                     | PO | JO |
| Qendrat ekologjike në të cilat ndodhen parqet e njohura kombëtare | PO | JO |
| Emrin e ka marrë nga themeluesi i qytetit                         | PO | JO |

1 pikë

10. Duke marrë parasysh temën dhe mënyrën e përpunimit, cili tekst të ka pëlqyer më shumë? Argumentoje përgjigjen.

---

---

1 pikë

11. Shkruaje sinonimin e fjalës së nënvizuar.

Do të pushtoheni nga qyteti i vendosur rrezë malit të Rumisë, në mes të dy ujërave të mëdha, Detit Adriatik dhe Liqenit të Shkodrës.

Sinonimi: \_\_\_\_\_

1 pikë

**12. A) Rretho numrin para përkufizimit të saktë.**

1. Fonemat bashkohen në rrokje, rrokjet formojnë fjalë, fjalët formojnë fjali.
2. Fjalët bashkohen në fonema, rrokjet formojnë fjali, fonemat formojnë fjali.
3. Fjalitë formojnë fonema, rrokjet bashkohen në fjali, rrokjet formojnë fonema.

1 pikë

**B) Argumento përgjigjen nën A.**

---

---

---

1 pikë

**13. Përcakto llojin e funksionit të gjymtyrëve në fjali *Natë vjeshte të tretë.***

*Natë* \_\_\_\_\_  
*vjeshte* \_\_\_\_\_  
*tretë* \_\_\_\_\_

1 pikë

**14. Sinonimi i fjalës së nënvizuar në fjalinë *Befas dritaret u trandën, është:***

---

1 pikë

**15. A) Përshkruaj ose nënvizo përemrat nga fjalia:**

*Kush zgjoi tek ai këto urrejtje ndaj mbarë njerëzimit?*

---

1 pikë

**B) Emërto përemrat e përshkruar ose nënvizuar nga detyra nën A.**

\_\_\_\_\_

1 pikë

**16. A) Rretho numrin para fjalës së shkruar saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.**

1. çvendos
2. çvesh
3. çnderim

1 pikë

**B) Shkruaj C ose S që fjalët të jenë të shkruara saktë.**

funk\_\_ion, juridik\_\_ioni, sank\_\_ion    frak\_\_ionist, infek\_\_ion

1 pikë

**17. Shkruaj saktë shkurtesat e fjalëve:**

Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Malit të Zi \_\_\_\_\_

e të tjera \_\_\_\_\_

trajtë e shkurtër \_\_\_\_\_

urim \_\_\_\_\_

1 pikë

**18. A) Folja në fjalinë *Shiu tashmë kishte pushuar është në kohën:***

1. e tashme
2. të kryer
3. më se të kryer

1 pikë

**B) Me cilin lloj të kallëzuesit është shprehur folja në fjalinë nën A?**

1 pikë

**Lexo poezinë në vijim pastaj zhvillo detyrat 19, 20, 21, 22 dhe 23.**

### **Atdheu**

O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka  
Më je nënë, më je motër, më je vëlla.  
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,  
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe.  
Ty për ditë të pat parë ime nënë  
Dheu në fund atë e pati ngrënë  
Numëruar t'i pat syri yt  
Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj  
Ti ke parë gjysh –stërgjyshërit e mi,  
Edhe eshtrat tretur ua ke parë ti  
Nga ti, shpirt – o, ata kurrë s'qenë ndarë.  
Pranë teje patën qeshur, patën qarë...  
Begatoje, o imzot, ti këtë vend!  
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!  
Hi u bëfshin gjithmon' armiqtë e tij!  
I begatë i lulëzuar qoftë ai,  
Një të ardhme pastë plot lumturi.

*Naim Frashëri*

**19. A) Rretho numrin para llojit të strofës me të cilën është shkruar poezia dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.**

1. katërshe
2. klasike
3. sonet

1 pikë

**B) Si quhet rima e përdorur në këtë poezi?**

---

*1 pikë*

**20. Cilin motiv e trajton poezia e dhënë?**

---

*1 pikë*

**21. A) Rretho numrin para figurës stilistike që përdor autori në vargun e nëntë dhe të dhjetë.**

1. alegorinë
2. kontrastin
3. personifikimin

*1 pikë*

**B) Shpjego domethënien e figurës së përdorur nën A.**

---

---

*1 pikë*

**22. Çfarë definicioni përkufizues na jep poeti në këtë poezi? Përshkruaje një prej vargjeve ku jepet ky përkufizim.**

---

---

---

*2 pikë*

**23. Me çfarë ligjërate përfundon poezia?**

---

*2 pikë*

*(Që të shihet qartë dhe të kuptohet plotësisht figura e kasabës dhe natyra e raportit të saj ndaj urës, duhet ditur se në qytet ekziston edhe një urë, ashtu sikurse ekziston edhe një lumë. Ai është Rzav dhe mbi të ura e drunjtë. Në fund të qytetit lumi Rzav derdhet në Drinë, ashtu që qendra e qytetit dhe njëkohësisht pjesa më e madhe e tij ndodhen në gjuhëzën me rërë të tokës në mes të dy lumenjve, të madhit dhe të voglit, që bashkohen, kurse periferia e shpërndarë shtrihet nga ana tjetër e urave, në bregun e djathtë të Drinës dhe në bregun e djathtë të Rzavit. Qyteti mbi ujë. Mirëpo edhe pse ekziston edhe një lumë dhe një urë tjetër, fjalët „mbi urë“ nuk nënkuptojnë askurrë urën e Rzavit, ndërtesën e thjeshtë prej drurit pa bukuri, pa histori, pa ndonjë kuptim tjetër përveç se ju shërben banorëve vendas dhe bagëtime të tyre për të kaluar, por gjithmonë dhe vetëm urën e gurit mbi Drinë.)*

*Ura është rreth dyqind e pesëdhjetë hapa e gjatë, kurse e gjerë rreth dhjetë hapa, përveç në mes, ku është e zgjeruar në dy tarraca të barabarta, nga të dy anët e rrugës së urës nga një, dhe arrin gjerësinë e dyfishtë. Kjo është ajo pjesë e urës që quhet portë. Aty, me fjalë të tjera, në shtyllën e mesme e cila në maje të saj zgjerohet, janë muruar nga të dy anët zgjerimet e lëshuara, ashtu që në atë shtyllë pushojnë, majtas dhe djathtas rrugës, nga një tarracë, guximshëm dhe harmonishëm të dala jashtë nga linja e parë e urës në hapësirë mbi ujin e zhurmshëm dhe të gjelbër në thellësi.*

**24. Shkruaj gjininë letrare dhe llojin që i përket vepra nga e cila është fragmenti i dhënë.**

(gjinia letrare)

(lloji letrar)

1 pikë

**25. Krahaso paragrafët, kështu që nëse konstatimi është i saktë rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë rretho P dhe shpjego përgjigjen.**

Ura për të cilën flitet në paragrafin e dytë është ura e Rzavit.

S

P

Shpjego përgjigjen.

---

---

2 pikë

**26.** Kujto zhvillimin e ngjarjes në veprën *Ura mbi Drinë* pastaj shpjego qëllimin e paragrafit të parë në fragment.

---

---

2 pikë

**27.** Veprën përkatëse letrare (nga lista poshtë tabelës) shkruaje në fushë pranë personazhit nga ajo vepër (një vepër është e tepërt).

| PERSONAZHI     | VEPRA LETRARE |
|----------------|---------------|
| Tatjana        |               |
| Kreonti        |               |
| Mersoja        |               |
| Serdar Jankoja |               |

Kurora e maleve

Antigona

Ura mbi Drinë

Eugjen Onjegjin

I huaji

1 pikë

**28.** Përshkruaje karakteristikën që ka të bëjë me realizmin.

grumbullimi i mjeteve stilistike; interesimi për letërsinë popullore; motivimi social

---

1 pikë

## Lexo vargjet e mëposhtme dhe zhvillo detyrën 29.

“S’ka e s’ka si heroizma,  
Edhe si idealizma,  
Po kur dimër del behari  
S’ka si zjarri.”

- 29.** Shkruaje emrin e poezisë prej ku janë marrë vargjet e dhëna, autorin e saj, si dhe emrin e personazhit kryesor të kësaj poezie.

Poezia \_\_\_\_\_

Autori \_\_\_\_\_

Personazhi \_\_\_\_\_

3 pikë

- 30.** Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rrethoje numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

### 1. “Në botë vijmë vetëm njëherë”

Lexo me kujdes fragmentin nga vepra *Vajza me portokalli* si dhe udhëzimet për hartimin e esesë.

*Në romanin e Justejn Gorderit „Vajza me portokalli“, djaloshi e gjen një letre dhe në te një pyetje, të cilën babai i sëmurë ia kishte dërguar njëmbëdhjetë vjet më parë.*

„Gjatë javëve të fundit shumë herë ia kam shtruar vetes të njëjtën pyetje. A do të zgjedhja të jetoj në Tokë i vetëdijshëm se befas do të isha i shqyer nga të gjitha, ndoshta në mes të gjendjes së dehur nga lumturia? Ose, menjëherë në fillim, do të falënderoja dhe do të refuzoja të marr pjesë në atë lojë të rrezikshme “marrë-

dhënë"? Sepse, në botë vijmë vetëm një herë. Na lënë në përrallën e madhe. Dhe fjala në vesh, e mira prej nesh! (...)

Ndoshta po futem tepër thellë. Ndoshta po të hapë tepër. Ndoshta në këtë nuk kam të drejtë. Por, është shumë e rëndësishme për mua çfarë përgjigjesh do të japësh në pyetjen të cilën ta kam shtruar, pasi që jam drejtpërdrejt përgjegjës për atë që ti je këtu. Prandaj, ti nuk do të mund të ekzistojë në këtë botë sikurse unë të kisha hequr dorë nga ajo.

Ndoshta ndiej ndonjë lloj *faji* që kam marrë pjesë në ardhjen tënde në botë.

Në ndonjë mënyrë unë ta kam dhënë këtë jetë, ose, më saktësisht, Vajza me portokall dhe unë, natyrisht. Por në atë mënyrë ne pikërisht një herë edhe do ta marrim. T'i dhurosh jetën fëmijës nuk do të thotë vetëm t'i Dhurosh Botën. Ajo do të thotë gjithashtu edhe t'ia marrësh të njëjtën dhuratë të pakuptimtë.

Duhet të jem i singertë, Xhorxh. Unë thash se ndoshta do të falënderoj dhe do ta refuzo me një shpejtësi të rrufesë atë shikimin turistik të përrallës së madhe. Me të vërtetë do ta refuzoja. Dhe nëse mendon njëlloj si unë, ndjej fajin për atë që kam kombinuar.

Kam lejuar që Vajza me portokall të më bëjë për veten, lejova që dashuria të më marrë, lejova që të më tërheq mendimi në fëmijë. Tashti arrin pendesa dhe nevoja që të më falësh. A kam gabuar diku? Pyetjen e kuptoj si një konflikt të përgjakur në ndërgjegjen e ndarë. Dhe lind edhe nevoja që të rregulloj pas vetes.

Mirëpo, Xhorxh, tani paraqitet një dilemë e re, dhe ajo ndoshta nuk është aq e vështirë – ose e rrezikshme – sikurse e para. Nëse *ti* përgjigjesh se edhe përkundër të gjithave do të zë zgjedhje të jetosh, edhe pse vetëm shkurtimisht, atëherë, në përgjithësi, nuk kam të drejtë të dëshiroj sikur kurrë mos të kisha lindur.

Kështu në këtë llogari mund të vendoset njëlloj baraspeshe, dy kapituj atëherë shtyhen. Natyrisht, shpresoj kështu. Po, për këtë arsye edhe po shkruaj. Nuk mund të më përgjigjesh drejtpërdrejt në pyetje të cilën e kam shtruar. Por mund të më përgjigjesh në mënyrë indirekte. Mund të më përgjigjesh me zgjedhjen tënde, me mënyrën në të cilën do ta jetosh këtë jetë të cilën e ke filluar kur unë dhe Veronika, mjeku i padëgjueshëm dhe unë në spital kemi përpjekur gotat me shampanjë për nderin tënd. Ai mjeku shampanjë ka qenë zana jote e mirë, në këtë jam plotësisht i sigurt.

### **Udhëzim për shkrimin e esesë:**

- Duke u bazuar në tekst, shpjego përse jeta e njeriut është tragjike.
- Shpjego ndjenjën e fajësisë së babait. Ku e sheh ai gabimin më të madh të tij?
- Shpjego si mund të ndikojë djaloshi që të vendoset baraspesha në tregimin për jetën dhe vdekjen. Si mund të përgjigjet djaloshi në pyetjen e babait të cilën e ka hasur në letër?
- Në cilën vepër letrare sumero-babilonase flitet për këtë problem? Duke u bazuar në tekst të asaj vepre, shpjego se si shikon në këtë problem personazhi kryesor.
- Paraqite pikëpamjen tënde për këtë problem.

## 2. Udhëtimet zgjerojnë horizontet dhe pasurojnë shpirtin

Udhëzim për shkrimin e esesë:

- A ke dëshirë të udhëtosh? Argumentoje përgjigjen.
- Ceki tri motive për udhëtim dhe argumentoji ato.
- Cilin vend në Mal të Zi do t'ua rekomandoje turistëve ta vizitojnë? Përse?
- Shkruaj nëse udhëtimet mund ta ndryshojnë shikimin e jetës, botës, njerëzve, kulturës...
- Ceke vendin apo vendet të cilat do të dëshiroje t'i vizitosh dhe përse?.

*25 pikë*













